	Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universiteti Prizren 1955
Pranuar më datë	09.01.2024
Zyra e pranimit	
308	01-29

 LEGAL DATA SOLUTIONS L.L.C	 Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren Fakulteti Juridik/Faculty of Law
--	--

**MEMORANDUM MIRËKUPtimi
(MM)**

NË MES TË

**UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" - PRIZREN
Fakulteti Juridik**

DHE

LEGAL DATA SOLUTIONS L.L.C.

LIDHUR ME

**QASJEN NË PLATFORMËN ELEKTRONIKE PËR HULUMTIM LIGJOR:
LEXDOKS.COM**

DUKE PASUR PARASYSH qëllimin e Universitetit "Ukshin Hoti" -Prizren/Fakulteti Juridik (këtu e tutje referuar edhe si Universiteti/FJ), për ofrimin e shërbimeve kualitative dhe efektive për stafin akademik dhe studentët, duke forcuar më tutje kapacitetet dhe aftësinë e hulumtimit akademik ligjor përmes përdorimit të mjeteve të sofistikuar teknologjike, dhe

DUKE PASUR PARASYSH qëllimin e Legal Data Solutions L.L.C. që ta promovoj dhe shpërndajë platformën lexdoks.com (këtu e tutje referuar edhe si: "Platforma" apo "Lexdoks") në përdorim për sa më shumë profesionist dhe praktikues të ligjit;

Palët pajtohen si në vijim:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MM) është që të kornizohet marrëveshja e bashkëpunimit për sa i përket ofrimit të qasjes në platformën lexdoks.com për studentët dhe stafin e Fakultetit Juridik të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Neni 2 Obligimet e Legal Data Solutions L.L.C.

1. Legal Data Solutions L.L.C. zotohet për të përmbushur obligimet si në vijim:
 - 1.1. Lejimin e hapjes deri 80 llogarive për qasje në përdorim zyrtarë nga Universiteti /FJ.
 - 1.2. qasje të plotë në mundësinë e hulumtimit në të gjithë legjislacionin primarë dhe sekondarë (aktualisht mbi 1000 akte të Kuvendit, duke përfshirë ligjet në fuqi, të ndryshuara dhe të shfuqizuara).
 - 1.3. qasje në mundësitë e hulumtimit të praktikës gjyqësore të Gjykatave në vijim:
 - a) Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)
 - b) Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
 - c) Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
 - d) Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës,
 - e) Gjykatave Themelore dhe degëve të tyre në Republikën e Kosovës.
 - 1.4. Mundësi kërkimi dhe hulumtimi në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës,
 - 1.5. Mundësi kërkimi dhe hulumtimi në aktet nënligjore të Qeverisë dhe të Ministrive,
 - 1.6. Mundësi kërkimi dhe hulumtimi në aktet e Presidencës,
 - 1.7. Mundësi kërkimi në aktet e nivelit lokal (komunave) si dhe të institucioneve të pavarura.
 - 1.8. Mundësi kërkimi dhe hulumtimi në çdo akt tjetër që do t'i shtohet platformës lexdoks.com në kohën e vlefshmërisë së kontratës.
2. Lexdoks obligohet që t'i ofrojë Universitetit /FJ casje në hulumtim të pa kufizuar në kohë brenda ditës apo brenda muajit.
3. Lexdoks dhe Universiteti/FJ e kuptojnë që në disa raste, gjatë përditësimit të platformës casja mund të jetë, përkohësisht jo e plotë.
4. Lexdoks obligohet që të shfaqë vizualisht Logon e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, në listën e partnerëve në kanalet sociale dhe në faqen zyrtare të platformës.
5. Lexdoks do të publikojë të paktën 5 artikuj/postime në të cilat Universiteti/Fakulteti dhe Lexdoks promovohen bashkarisht.
6. Lexdoks do të ndajë me Universitetin/Fakultetin çfardo përditësimi të rëndësishëm të platformës ashtu që përdoruesit të jenë të informuar për mundësitë më të fundit hulumtuese.

Neni 3

Obligimet e Universitetit/FJ

1. Universiteti/Fakulteti obligohet që :

- 1.1. Të promovojë dhe bëjë publike faktin që Universiteti/Fakulteti është partner me/dhe përdorues i Lexdoks,
- 1.2. Të publikojë të paktën 5 artikuj/postime në të cilat Lexdoks dhe Universiteti/FJ promovohen bashkarisht,
- 1.3. T'i njoftojë studentët për partneritetin me Lexdoks ashtu që të njejtit të mund të regjistrohen dhe ta përdorin të njejtën,
- 1.4. T'i mundësoj personave të autorizuar të Lexdoks që të organizojnë sesione informuese dhe promovuese për Lexdoks në Fakultetin Juridik të Universitetit;
- 1.5. T'i ofrojë Lexdoks të gjitha të dhënat e nevojshme për regjistrimin e përdoruesëve sipas këtij Memorandumi,
- 1.6. Në pajtim me procedurat ligjore dhe rregullative ta përfshijë regjistrimin në Lexdoks në parashikimet buxhetore për periudhën vijuese pas skadimit të këtij Memorandumi.

Neni 4

Regjistrimi i përdoruesve

1. Universiteti do të ndajë me Lexdoks të dhënat që janë të nevojshme për regjistrimin/identifikimin e përdoruesve.
2. Lexdoks do të regjistrojë/vazhdojë/përfundojë regjistrimin përdoruesve sipas informatave që Universiteti do të përcjellë tek Lexdoks në baza të kohëpaskohëshme.

Neni 5

Përiudha e përdorimit pa pagesë dhe marrëveshja për çmimin e anëtarësimit pas afatit të kontraktuar pa pagesë

1. Lexdoks do t'i ofrojë Universitetit /FJ anëtarësimin falas në platformën Lexdoks për pesëdhjetë (50) përdorues/studentë dhe staf akademik, pa pagesë për një periudhë prej gjashtë muaj.
2. Pas skadimit të periudhës pa pagesë palet do të ri-negociojnë vazhdimin potencial të abonimit varesisht nga pajtimi reciprok në kohën kur bëhet ri-negocimi.
3. Periudha e ri-negocimit fillon 30 ditë para skadimit të periudhës pa pagesë.
3. Periudha nga paragrafi 1 fillon të rrjedhë nga momenti kur Lexdoks lanson sistemin e pagesës në baza mujore në masë të gjerë.

Neni 6
Përiudha e vlefshmërisë së Memorandumit dhe pjesëve të tij

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është i vlefshëm për një periudhë dy (2) vjeqare, kurse pjesët e caktuara të tij vlejné sipas përcaktimit specifik të dispozitave.

Neni 7
Denoncimi dhe përfundimi i Memorandumit


Secila palë mund të denoncojë Memorandumin e Mirëkuptimit në një periudhë paralajmërimi prej 30 ditëve kalendarike.

Neni 8
Hyrje në fuqi dhe kopjet

1. Ky Memorandum bëhet i vlefshëm nga dita vijuese e datës së nënshkrimit nga të dyja palët.
2. Ky Memorandum bëhet në 3 kopje, nga një për secilën palë dhe një për arkivën e Lexdoks.

Për: Legal Data Solutions L.L.C.

Alban Muriqi
U.D.Drejtori i Menaxhimit



Për: Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren

Prof.Asoc.Dr. Mentor Alishani, Rektor

